

**NDËRLIDHJA NË MES TË PËRDORIMIT TË TEPËRT TË INTERNETIT APO  
VARËSIS NGA INTERNETI DHE PERFORMANCËS AKADEMIKE TEK  
NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME TË LARTA**

**MASTER I ARTEVE NË PROGRAMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE  
KËSHILLIM**

**Nga:**

**Blerta Azemi**

**Mentore e Temës: Prof. Asoc. Liridona Jemini-Gashi**



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**

**FAKULTETI FILOZOFIK**

**DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË**

**Nentor, 2022**

**Kandidatja:** Blerta Azemi

**Mentorja:** Prof. Asoc. Liridona Jemini-Gashi

Qëllim kryesor i këtij studimi është të hulumtoj marrëdhënien midis varësisë nga interneti dhe performancës akademike midis nxënësve të shkollave të mesme të komunës së Podujevës. Kështu, nëpërmjet këtij punimi shohim se si përdorimi i tepërt i internetit apo varësisë nga internet po afekton performance akademike të nxënësve. Poashtu, studimi përqendrohet gjithashtu në ekzaminimin e dallimeve gjinore midis nxënësve në varësinë nga interneti. Me anë të realizimit të këtij studimi synojmë të identifikojmë se deri në çfarë mase nxënësit e shkollave të mesme e përdorin internetin dhe se si kjo po ndikon në performancën e tyre akademike. Duke u mbështetur në rëndësinë që ka procesi edukativo-arsimor tek e ardhmja e nxënësve, është shumë e rëndësishme që t'i kushtojmë vëmendje nivelit të përdorimit të internetit tek nxënësit.

Punimi është i ndarë në 4 kapituj:

### **Kapitulli I:** Hyrje (Përshkrimi i problemit studimorë)

Në pjesën hyrëse të punimit shpjegohet rëndësia e përdorimit të internetit nga ana e nxënësve dhe mënyrën se si ky përdorim i internetit në qoftëse bëhet në mënyrën jo adekuate dhe në sasinë jo të duhur, atëherë ajo do ketë impakt negative tek nxënësit, pavarësisht të gjitha aspekteve të tjera pozitive që ka interneti. Shumica e fëmijëve në ditët e sotme kanë akses në një kompjuter dhe është bërë e zakonshme për fëmijët dhe adoleshentët të mbajnë celularë, megjithatë, edhe pse kjo mund t'i qetësojë prindërit sepse ata mund të kenë kontakt të dyanshëm me fëmijën e tyre në rast urgjence, ekzistojnë rreziqe shumë reale ndaj të cilave kjo qasje e vazhdueshme në internet mund t'i ekspozojë ata. Nga ana tjetër, shumë studentë mbesin prapa në performancën e tyre akademike për shkak të investimeve të tepërta në marrëdhëniet online dhe përdorimit të panevojshëm të mediave sociale, të cilat quhen varësia nga Interneti

Studimi ka 2 hipoteza:

**H1** Egziston një ndërlidhje negative në mes të varsisë dhe performancës akademike tek nxënësit e shkollave të mesme.

**H2** Egzistojnë dallime gjinore signifikante në varësin nga internet tek nxënësit e shkollave të mesme?

## **Kapitulli II:** Shqyrtim i literatures-perspektiva teorike

Në kapitullin e dytë, është bërë paraqitja e të gjeturave nga literatura, se si është hulumtuar edhe nga studimet e mëparshme përdorimi i tepërt i internetit në performancën akademike të nxënësve, kështu duke u dhënë kështu përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura me qëllim zbërthimin e qëllimit të përgjithshëm të studimit. Gjithashtu, janë definuar operacionalisht variablat që do të hulumtohen, faktorët individual dhe kontekstualë që prezantohen zakonisht në literaturë. Pjesë e rëndësishme e këtij seksioni është edhe pikëpamja teorike që i jep bazën e mbështetjes studimit tonë edhe pse është një pikëpamje relativisht e re.

## **Kapitullit III:** Metodologjia

Në pjesën e metodologjisë, përshkruhen atributet e pjesëmarrësve të këtij hulumtimi, shpjegohet mënyra e mostrimit, metoda e përdorur për realizimin e hulumtimit, instrumentet matëse, çështjet etike në lidhje me pjesëmarrësit dhe analizat statistikore të përdorura për t'u dhënë përgjigje eventuale hipotezave. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim kanë qenë 300 nxënës të 3 shkollave të mesme të qytetit të Podujeves (te klases X kane qene 145 nxenes dhe klases XI kane qene 155 nxenes). Moshja e pjesëmarrësve kanë qenë 15-17 vjeq, ku prej tyre kane qene 146 femra (48.7%) dhe 154 meshkuj (51.7%). Ky studim është një studim korrelacional ndër-seksional, i natyrës kuantitative dhe si i tillë ka për qëllim të hetoj ndërlidhje në mes të përdorimit të tepërt të

internetit/varsisë dhe performancës akademike tek nxënësit e shkollave të mesme të larta. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur pytesori Internet Addiction Test (IAT), kurse sa i përketë performancës akademike ajo është regjistruar në formën e notës mesatare (suksesit të përgjithshëm) të marrë nga vlerësimi i përgjithshëm i lëndëve të tyre akademike sipas të dhënave të shkollës përkatëse.

#### **Kapitulli IV: Rezultate, Diskutim, Limitime, Rekomandime, Referenca dhe Shtojcë**

Te pjesa e rezultateve, përshkruhen rezultatet në mënyrë të përmbledhur, duke ripotencuar dhe diskutuar të gjeturat në mbështetje të literaturës të parashqyrtuar, po ashtu, duke u prezantuar limitimet shkencore të studimit, të mbështetura me të dhëna konkrete për hulumtimet e radhës. Rezultatet tregojnë se përdorimi i tepërt i internetit nuk ka ndërlidhje pozitive me performancën akademike të nxënësve, që mbështet hipotezën e parë të studimit, poashtu, edhe rezultatet mbi dallimet gjinore tregojnë që ka dallime gjinore signifikante në mes të përdorimit të tepërt të internetit tek djemtë dhe vajzat, ku djemtë kanë një tendencë më të shtuar në përdorimin e internetit sesa vajzat, rezultate këto të cilat e mbështesin hipotezën tone të dytë. Gjithashtu me anë të këtij studimi përpiqemi të kontribuojmë sado pak në shkolla, duke dhënë rekomandime për vedijësimin mbi varësin nga internet tek nxënësit dhe ndikimin negativë të saj në jetën e tyre.